



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Politikë dhe financa
Nr.01-060/01-1817/25 datë:20.01.2025



Npi – 01/14 datë: 24.01.2025

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Si dhe në bazë të nenit 4.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/155 datë: 27.04.2023, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 24.01.2025 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I MBLEDHJES SË -I- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA

E mbajtur më datën: 24.01.2025 (e premte) në ora 10:00 h. në sallën e vogël të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, Anëtarët e Komitetit: z.Përparim Ramusa, z.Lumni Amrush, znj.Adelina Beqaj, znj.Saniye Sadiki, znj.Zejnije Velu dhe z.Kadri Emini. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje ka marrë pjesë edhe: Drejtorët – z.Grejtalb Emini, znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, z.Gojart Bajrami, Inspektorja për Ambient znj.Albulena Emini, Zyrtarët për Informim znj.Vlora Hyseni, dhe Albion Shabani.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesi i KPF-së z.Adnan Ademi, i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin e mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje kemi propozuar këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.12.2024,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024,
3. Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim paraprak për dhënjën në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024,
7. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt,

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se ta hapi diskutimin për rendin e ditës, e kamë një kërkesë për një pike shtesë nga Drejtoria e Shëndetësisë, për sa i përket Subvencionimit të Nënave Lehona. "Propozim-Vendim për subvencionimin e Nënave Lehona për çdo fëmijë të lindur"

z.Përparim Ramusa: Përshëndetje. Pajtohem me pikat e rendit të ditës gjithashtu edhe me pikën shtesë për subvencionimin e Nënave Lehona.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi rendin e ditës., si vijon:**

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.12.2024,
2. Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoha për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024,

3. Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024,
4. Propozim-Vendim paraparak për dhënjën në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime,
5. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
6. Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024,
7. Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt,
8. Propozim-Vendim për subvencionimin e Nënave Lehona për çdo fëmijë të lindur.

Pika 1

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më: 23.12.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Hapi diskutimin për këtë pikë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht miratoi Ekstrakt-Procesverbalin nga mbledhja e mbajtur më 23.12.2024.**

Pika 2

Rishikimi i Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Para se të hapi diskutimin për këtë pike, fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmetit për prezantimin e kësaj pike.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Përshëndetje. Është e qartë se Ministria e Bujqësisë ka kërkuar rishikimin e Rregullores për Taksa për vitin 2025, ndryshimet që janë kërkuar të bëhen kanë të bëjnë me Drejtorinë e Bujqësisë, prandaj unë mendoj se drejtori Gojart Bajrami kishte me dhënë sçarime më të detajuara.

z.Gojart Bajrami, drejtor i DBPZHR: Përshëndetje. Sa i përket këtijë ndryshimi të rregullorja për Taksa për vitin 2025 që ka të bëjë me nenin 8.2 për vendosjen e tarifave për “Shërbimet profesionale për prerjen e pyjeve private”, unë kam pasë disa takime pune në Ministrinë e Bujqësisë. Kemi diskutuar dhe kemi arritur në përfundim se në rregullore duhet të ekzistojnë qmimet për kryerjen e këtyre shërbimeve, sikurse ka qenë edhe të kaluarën. Me memorandum, Nr.02/280 të datës 19.12.2023, bëhet transferimi i stafit të pylltarisë nga Komuna e Shtimes në Agjencionin Pyjor të Kosovës, bashkë me mjetet buxhetore përkatëse, automjetet, paisjet tjera dhe përgjegjësitë. Kështu pra ne si Komunë jemi të obliguar për me e zbatuar Udhëzimin Administrativ të MBPZHR Nr.07/2010 për Procedurat e dhënies së lejeve për prerje.

z.Përparim Ramusa: Ne sigurisht që duhet ta respektojmë infrastrukturën ligjore, dhe për këtë arsye ne jemi “Pro”.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e Rregullores Komunale për Taksa, Tarifa dhe Gjoba për vitin 2025 Npi-01/381 dt. 29.11.2024, sipas rekomandimit të MBPZHR – Nr.4614/2 dt.27.12.2024.**

Pika 3

Raporti Vjetor Buxhetor i Komunës së Shtimes për Janar-Dhjetor 2024

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja jap drejtorit Besnik Ahmeti.

z.Besnik Ahmeti, drejtor i DBF: Ne e kemi obligim ligjor që ta prezantojmë raportin vjetor buxhetor para Kuvendit. Materialin për këtë pike e keni marrë me kohë dhe e keni lexuar, prandaj unë nuk do të ndalem në detaje, por në pikat kryesore. Në vazhdim lexoi pikat kryesore të raportit sipas shifrave të radhitura nëpër kategoritë ekonomike (shih raportin). Nëse ka ndonjë pyetje jam këtu për tu përgjigjur. Ju ftoj që ta votoni, sepse kemi një buxhet të realizuar si kurrë më parë në shumën prej 11,043,479.98 euro ose 97.20%.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, me 4 vota “Për” me 3 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstënim” vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Raportit Vjetor Buxhetor të Komunës së Shtimes për periudhën Janar-Dhjetor 2024.**

Pika 4

Propozim-Vendim paraprak për dhënjën në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime
Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtorit Grejtalb Emini.
z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Përshëndetje. Bazuar në nenin 4 dhe 8 të Ligjit për dhënjën në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092, Kuvendi duhet të miratoi një vendim paraprak për dhënjën në shfrytëzim afatgjatë pronën Komunale. Lidhur me këtë vendim kemi disa kërkesa nga bizneset për vendosje të paneleve solare, kështu që qëllimi i dhënies së pronës komunale në shfrytëzim ka të bëjë me prodhimin e energjisë së ripërtrishme, kështu që ne kemi menduar që tokën me dhënë në shfrytëzim për 30 ose 40 vjet për aq sa edhe parashihet jetëgjatësia e këtyre paneleve. Tjtër nuk kam, përveq se ju ftoj që ta miratoni.
z.Përparim Ramusa: Ne si subjekt PDK për këtë propozim vendim jemi “Pro” mirëpo po kërkoj që le të na sqaron pak më shumë drejtori se për sa sipërfaqe po bëhet fjalë dhe ku gjinden këto toka?
z.Grejtalb Emini, drejtor i DPUKGJ: Lidhur me kërkesat për prodhimin e energjisë solare komuna e Shtimes premton zhvillim të shpejt të këtij sektori, kështu që edhe bizneset e kanë vërejtë këtë dhe po nguten të gjejnë hapsirë të mjaftueshme. Kemi 14 hektarë tokë komunale mbi Hallën e Sportit. Po ashtu edhe 8 hektarë nën Hallën e Sportit, mirëpo nuk është e thanun që ne me e dhënë krejt sipërfaqen në shfrytëzim. Parakusht dhe si motiv shtesë për këtë lloj investimi atje është ndërtimi i Nënstacionit Elektrik prej 110KW që pritet të ndërtohet së shpejti.
z.Përparim Ramusa: Ne e kemi votuar dhënjën e një prone atje për ndërtimin e një Nënstacionit Elektrik prej 110KW, kështu që ne në parim jemi “Pro” që të ju japim mundësi bizneseve.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit paraprak për dhënjën në shfrytëzim parcelat Komunale në Z.K-Shtime.**

Pika 5

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit,
Npi-01/162 dt. 27.04.2023,
Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtoreshës Mimoza Salihu.
znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Përshëndetje. Ne kemi përgatitur një ndryshim të vendimit për rritjen e çmimit nga 250 në 300 euro për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për qytetarët e komunës tonë, duke pasqyruar rritjen e gjithanshme të çmimeve. Nëse ka ndonjë pyetje unë do të përpiqem të përgjigjem. Ju ftoj që ta votoni.
z.Përparim Ramusa: Këto ndryshime vijnë si rezultat i rritjes së çmimeve, prandaj ne jemi “Pro”.
*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimitisht vendosi t’i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, Npi-01/162 dt. 27.04.2023, (nga 250 euro në shumën prej 300 euro).**

Pika 6

Propozim-Vendim për ndryshimin e vendimit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024
Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtoreshës Mimoza Salihu.
znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Sigurisht që kemi rritje të çmimeve, dhe këto familje kanë sfida për ti rritur këta fëmijë, për të cilët ne u jemi falënderues, dhe për këtë arsye ne kemi propozuar, ndryshimin e vendimit Npi-01/237 për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore, duke e rritur shumën në 150 euro në muaj. Nëse ka pyetje do të përgjigjem. Ju ftaoj që ta miratoni.
z.Përparim Ramusa: Ne si subjekt i PDK-së për këtë propozim jemi “Pro”.
znj.Adelina Beqaj: Përshëndetje. Ne e kemi miratuar vendimin fillestar për këtë kategori në shumën prej 100 eurove, nëse e shikojmë shumën që e miratuar për shpenzimet e varrimit me 300 euro mua po më duken 150 euro shumë pak. Unë kam pritë që shuma do të jetë më e madhe.
znj.Zejnije Veliu: Përshëndetje. E vërtetë është se sado që e rrisim shumën është pak për këtë kategori. Mirëpo e kam vërejtë se është në procedurë ligji i ri se ato familje do të kenë një pagë mujore, si dhe do tu njihet përvoja e punës, të kësaj kategorie të familjeve, kështu që kjo do të jetë një ndihmesë shtesë.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndryshimin e vendimit të Kuvendit për subvencionimin me 100 euro në muaj Familjet që strehojnë fëmijë pa përkujdesje prindërore Npi-01/237 dt. 04.07.2024, (nga 100 euro në shumën 150 euro).**

Pika 7

Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha Albulena Emini.

znj.Albulena Emini, Inspektore e Mjedisit: Përshëndetje. Draft-Plani ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave është finalizuar, e që në këtë plan është punuar rreth dy vite, së bashku me Organizata të ndryshme ndërkombëtare siç janë GIZ- Gjerman etj. Ky plan është bukur i mirë sepse është plan i integruar i cili i përfshinë rajonet e Gjilanit dhe Ferizajt. Në këtë plan përfshihet riciklimi dhe kompostimi i mbetjeve. Ky plan është i mirë edhe për faktin se ka edhe të përcaktuara afatet kohore për realizim. Këtu janë të parapara edhe Aktivitetet të cilat do të fillojnë në vitin 2025. Në këtë Plan janë të inkuorpuara 12 Komuna. Shpresoj që të jetë i realizuar ky plan e mos të ngelet vetëm në letër. Ky plan është i nënshkruar edhe nga Kryetarët e Komunave, prandaj unë ju ftoj që ta miratoni fillimisht vendimin për ta nxjerrë në diskutim publik e pastaj krejt planin.

znj.Adelina Beqaj: Po shoh që në këtë plan është punuar shumë. Kështu që si draft plan po më pëlqen dhe do ta votoj. E falënderoj Albulenën për punën që ka qenë pjesë e Komisionit. Po shpresojmë që ka megjetë zbatim në teren dhe jo me mbetë vetëm në letër.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ta nxjerrë në diskutim publik, Draft-Plani Ndërkomunal për menaxhimin e integruar të mbeturinave për rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt. Bartëse e procesit të diskutimit publik është Drejtoria për Shërbime Publike në bashkëpunim me zyrën për informim.**

Pika 8 (shtesë)

Propozim-Vendim për subvencionimin e Nënave Lehona për çdo fëmijë të lindur.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi: Për prezantimin e kësaj pike fjalën ja dha drejtoreshës Mimoza Salihu.

znj.Mimoza Salihu-Qeriqi, drejtoresh e DSHMS: Te ky propozim-vendim e kemi vetëm kërkesën që mos të përsëritet nevoja që për çdo vit me qitë në Kuvend vetëm për shkak të vitit që po përcaktohet, pr aner po kërkojmë që viti mos të përmendet në vendim, por të vazhdon deri sa ka buxhet të miratuar për këtë qëllim. Dmth. Mos të jemi të detyruar që për një qështje të vitit duhet ta propozojmë ndryshimin në Kuvend. Ju ftoj që ta votoni këtë ndryshim.

z.Lumni Amrush: Përshëndetje. Ne si subjekt i PDK-së jemi "Pro" që në vendim të jetë i shënuar viti aktual dhe viti paraprak për ata që nuk kanë mundësi me apliku në vitin e kaluar.

*** Komiteti për Politikë dhe Financa, unanimisht vendosi t'i Rekomandon Kuvendit, miratimin e Vendimit për ndarjen e subvencioneve për nënat Lehona për ç'do fëmijë të lindur, si vijon:**

1. Fëmija i I-rë do të subvencionohet me 100 €;
2. Fëmija i II-të do të subvencionohet me 150 €;
3. Fëmija i III-të e tutje do të subvencionohen me nga 200 €;
4. Fëmijët binjakë do të subvencionohen me 500 €;
5. Fëmijët trinjakë do të subvencionohen me 1000 €;
6. Shumës prej 1000 € (për trinjakë) do t'i shtohen edhe nga 500 € për çdo fëmijë të lindur njëkohësisht më shumë se trinjakë.

Kryesuesi, z.Adnan Ademi; Meqenëse diskutime tjera nuk ka, Kryesuesi mbledhjen e përfundoi në ora 10:51h.

Procesmbajtësi
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i KPF
Adnan Ademi

